



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1107/2 prot.

Tiranë, më 07 . 11 . 2023

V E N D I M

Nr. 230, datë 07 . 11 . 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr.211 Regj., datë 12.10.2023, të subjektit ankues B. Z, kundër Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “At’ Gjon Karma”, Gur i Zi, Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes familjare” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të parashtruara nga subjekti ankues dhe dokumentacionit të depozituar, rezulton se, B. Z ushtron profesionin e mësueses prej 27 vitesh, nga të cilat, 4 vite ka punuar si mësuese provizore në shkolla të ndryshme, 17 vite në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Hasan Meti”, Mjedë dhe 6 vitet e fundit, në Shkollën e Mesme të Bashkuar “At’ Gjon Karma”, Gur i Zi, ku ka punuar me fëmijët me aftësi të kufizuar. Ankuesja ka cituar se 1 vit ka punuar në projektin “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe se gjithmonë është vlerësuar pozitivisht për punën e saj.

Në shpjegimet e depozituara pranë KMD-së, ankuesja, ndër të tjera shpjegon se: “Dy vitet e fundit për shkak të pikëzimit dhe situatave të ndryshme që drejtoresha e shkollës ka krijuar për të më ulur

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

pikët në dosje në mënyrë që të favorizojë mësueset me të cilat ka marrëdhënie shoqërore, ndaj meje është ngritur një komisionin disiplinor për shkak të një fjale që sipas tyre kam thënë gjatë orës së mësimit, dhe për këtë janë thirrur edhe prindërit e nxënësve. Kjo situatë është bërë me qëllim nga drejtoresha, e cila për të më ulur pikët më ka bërë dhe presion duke më thënë do të vë kolektivin kundra dhe mbledhjet i fillon me një fjalor jo etik, ndërsa mua më nxjerr në komision disiplinor për një fjalë të dalë instiktivisht që nuk e mbaj mend mirë se si mund ta kem thënë konkretisht. Më pas më heqin 1 pikë për mesataren e diplomës. Megjithatë, pas shumë situatave dal e 6-ta në renditje. Drejtoresha nuk e bën publik pikëzimin e Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve (KVD) të Shkollës dhe arrin të punësojë mësuesen që në renditje ishte e 7-ta, duke i lënë në ngarkim fëmijë me aftësi të kufizuar, ndërkohë që unë jam e punësuar me emërimin si mësuese mbështetëse, pikërisht për këta fëmijë, fushë në të cilën kam punuar prej 5 vitesh dhe është një punë që e bëj me përkushtim e përgjegjshmëri”.

Ankuesja pretendon se vlerësimi i dosjes së saj nga KVD i Shkollës është jo objektiv dhe nuk është vlerësuar drejt, ndërsa shprehet se, në renditjen e KVD së Zyrës Arsimore Shkodër është renditur e 12-ta, ndërsa mësuesja me të cilën është zëvendësuar e 14-ta.

Më tej, ajo citon se: *“Për të rregulluar situatën ZVAP Shkodër për të mos më prishur kontratën si mësuese definitive më emëron në Nicaj-Shalë, Shkodër, e cila është një zonë malore dhe kjo për mua është në diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, pasi unë jam diagnostikuar me gurë në tëmth dhe udhëtimi në zonë malore mund të ma përkeqësojë shëndetin dhe për këtë janë në dijeni. Po ashtu pretendoj edhe për diskriminim për shkak të gjendjes familjare pasi kam në ngarkim prindërit dhe unë kujdesem për ta dhe babai është paraplegjik. Unë nuk mund të shkoj në atë zonë dhe për faktin se unë isha shumë mirë tek shkolla ku isha dhe drejtoresha kishte mundësi të më sistemonte aty ku isha, dhe jo të favorizonte për shkak të lidhjeve shoqërore mësuesen tjetër, duke bërë zgjedhje subjektive. Gjithashtu jam regjistruar në Universitet dhe po ndjek masterin dhe lëvizja ime në një zonë të largët e bën të pamundur ndekjen e tij.”*

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për rikthimin e saj në pozicionin e punës që mbante në Shkollën e Mesme të Bashkuar “At’ Gjon Karma”, Gur i Zi, Shkodër.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), garanton mbrojtje nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh. Në nenin 1 të LMD parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje*

me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”,* ndërsa në nenin 12, *“Ndalimi i diskriminimit”*, pika 1, gëma “c”, të po këtij ligji, parashikohet: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës nr. 211 datë 12.10.2023, rezultoi se ajo nuk ishte e plotë për të vijuar më tej shqyrtimin e saj.

Për rrjedhojë, me anë të shkresës me nr. 1104/1 prot., datë 19.10.2023, Komisioneri iu drejtua ankueses duke i kërkuar plotësimin e ankesës, veçanërisht në drejtim të provueshëmrisë së shkaqeve të pretenduara, si dhe të pasjes dijeni të tyre nga ana e subjektit kundër të cilit ka depozituar ankesën pranë KMD-së. (Shkresë e cila i është komunikuar edhe doravisht nëpërmjet Specialistes së Zyrës Rajonale Shkodër/KMD).

Subjektit ankues, në vijim të komunikimit me përfaqësuesen e ZR Shkodër, ka deklaruar para saj (në bisedën telefonike si dhe me sms) se për arsye personale do të tërhiqet nga shqyrtimi i ankesës së saj pranë Komisionerit.

Kontenti i e-mailit të dërguar nga ZR Shkodër, është si më poshtë citohet:

“Ankuesja B. Z më ka pohuar nëpërmjet sms dhe gjatë komunikimit në telefon se nuk do ta vazhdojë më tej shqyrtimin e çështjes së saj, falenderon Komisionerin për impenjimin dhe tërhiqet nga ankesa e regjistruar pranë KMD-së, me nr. 211 regj., datë 12.11.2023. Për arsye personale

nuk ka mundur të paraqitet fizikisht pranë ZR Shkodër për të bërë tërheqjen nga ankesa në mënyrë shkresore.”

Në vijim, nëpërmjet e-mailit datë 06.11.2022³, nga Specialistja e ZR Shkodër/ KMD, është përcjellë vullneti i ankueses, e cila nëpërmjet deklaratës së depozituar pranë ZR Shkodër, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa e regjistruar me nr. 211 Regj., datë 12.10.2023, pranë Zyrës së KMD-së .

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar përcaktohet: “*3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.*

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ*”.

Në nenin 94⁴/1 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, parashikohet se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, B. Z, e cila, me anë të kërkesës të përcjellë ZR Shkodër me datë 06.11.2022, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 06.11.2023, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 211 regj., datë 12.10.2023, të paraqitur nga ankuesja B. Z, kundër Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “At’ Gjon Karma”, Gur i Zi, Shkodër, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

³ Depozituar në cilësi prove në dosjen e ankueses, pranë KMD-së.

⁴ “*Tërheqja e ankesës*”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 211 Regj., datë 12.10.2023, të subjektit ankues B. Z kundër Drejtores së Shkollës së Mesme të Bashkuar “At’ Gjon Karma”, Gur i Zi, Shkodër, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA